



Nr. Vendimi 611(532)
Dt. Vendimi 26.09.2016

përfundimisht pranimin e kerkese padisë sipas objektit të saj, përfaqesuesin e palëve të paditura z. Isidor Frashni, i cili u shpreh për rrëzimin e kerkese padisë si të pambështetur në ligje dhe prova, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi:

VËREN se;

Paditesi Shoqeria "Hidri" sh.p.k., me administrator Paulin Hidri, është drejtuar pranë gjykatës administrative shkallë e parë Shkoder, me kerkese padi kundër anes së paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore, Lezhe dhe Drejtoria e Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë, me objekt:

Shfuqizimin e aktit administrativ "Njoftim Vleresimit për Detyrime" nr.7035 Prot. dt.07.10.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhe;

Shfuqizimin e aktit administrativ "Njoftim Vleresimit për Detyrime" nr.9441/37 Prot. dt.29.10.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhe; —

Shfuqizimin e vendimit nr.32956/1 Prot., dt.21.12.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Shfuqizimin e vendimit nr.37836/3 Prot., dt. 14.01.2016 të Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Rrethanat e çështjes;

Shoqeria "HIDRI" sh.p.k. është shoqëri tregtare e regjistruar pranë Q.K.R. me NIPT K576173060, me objekt të veprimtarisë "Bar-Restorant", me adresë Lezhe, Laç.

Ne datën 12.09.2015, në ambientet e shoqërisë "Hidri" sh.p.k. janë paraqitur inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhe, të cilët kanë ushtruar kontroll pranë subjektit dhe në vijim kanë pasqyruar rezultatet e kontrollit në Akt - Konstatimin nr.0515202 dhe 05152013, dt. 12.09.2015 ku kanë pasqyruar faktet se:

Subjekti është i regjistruar në organin tatimor dhe në QKR me nr. NIPT K576173060;

-Subjekti e ka të instaluar kasën dhe gjithashtu është në gjendje pune;

- U verifikua afishimi i cmimeve të shitjes, si dhe kishte afishuar posterin për terheqjen e kuponit tatimor nga klientët;

- Në momentin e verifikimit u kontrollua leshimi i kuponit tatimor dhe rezultoi se nuk leshonte kupon tatimor.

- U verifikuan dhe punonjësit të cilët rezultuan të gjithë të deklaruar në organet përkatëse;

- U verifikuan cmimet e afishuara me cmimet sipas deklarimit të kases fiskale dhe rezultoi se ishin të njëjta;

Për sa më lartë me aktin administrativ "Njoftim Vleresimi për Detyrime" nr.7035 prot. dt.07.10.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhe, është ndeshkuar paditesi me gjoke në masën 50.000 leke, me arsyetimin se paditesi nuk kishte leshuar kuponin tatimor.

Me vendimin nr.32956/1 Prot., dt.21.12.2015, Drejtoria e Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka vendosur: Lenien në fuqi të aktit administrativ, Njoftim Vleresimit për Detyrime nr.7035 prot. dt.07.10.2015, për gjoben 50.000 leke për mosleshimin e kuponit tatimor.

Gjithashtu pala paditese është njoftuar me Njoftim Vleresimin për Detyrime nr.9441/37 prot. dt.29.10.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhe, për denimin me gjoke në masën 150.000 leke (me arsyetimin se është biznes i madhe dhe gjoka është 200.000 leke, e jo 50.000 leke, e për pasoje ka dale dhe akt njoftimi i mesiperm).

Me vendimin nr.37836/3 Prot., dt. 14.01.2016, Drejtoria e Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka vendosur: Lenien në fuqi të aktit administrativ,

njoftim vleresimit per Detyrime nr.7035 prot. dt.07.10.2015, per gjoben nga 50.000 leke per mosleshimin dhe rrezimin e ankimit.

Ne gjykim paditesi parashtroi se;

Akti administrativ "Njoftim Vleresimi per Detyrime" nr.7035 prot. dt.07.10.2015 i Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe, eshte nxjerre ne kundershtrim te plote me Ligjin nr.9920, date 19.5.2008, si dhe akteve nenligjore per faktin se pala e paditur keqinterpreteton dispozitat ligjore, e per rrjedhoje edhe akti administrative me te cilin eshte denuar me gjobe paditesi, eshte nxjerre ne kundershtrim me ligjin.

Neni 54/3 i Ligjit nr.9920, date 19.5.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" parashikon se:

sherbime ne njeedise apo njesi te perhershme, te hapura per publikun, duhet te instalojne pajisje fiskale dhe te leshojne kupona tatimore per cdo transaksion. "

Ndersa neni 55/1 i Ligjit nr.9920, date 19.5.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" parashikon se:

1. *Tatimpaguesit, qe kryejne qarkullimin e mallrave dhe te sherbimeve, per te cilat pagesat nuk kryhen nepermjet bankes, jane te detyruar te fusin dhe te perdorin sistemin fiskal, nepermjet perdorimit te pajisjeve fiskale, per regjistrimin e pagesave me para ne dore dhe per leshimin, ne menyre te detyrueshme, te kuponit tatimor.*

Ne rastin konkret ligjvenesi ka percaktuar qarte momentin se kur duhet te leshohet kuponi tatimor dhe konkretisht shprehet se kuponi tatimor duhet te leshohet ne momentin kur tatimpaguesi ka shitur mallin apo ka perfunduar sherbimin.

Ne rastin konkret rezulton se veprimtaria qe ushtron paditesi, eshte ajo e Bar - Restorant dhe ne rastin konkret ne momentin qe punonjesit e tatimeve kane ushtruar kontrollin prane paditesit, kane verifikuar dy tavolina, ku klientet sapo ishin ulur dhe kishin porositur per te ngrene.

Pra rezulton se eshte e vertete qe klientet kishin hyre ne ambientet e shoqerise dhe kishin porositur por ne ato moment ishin ende ne pritje te sherbimit nga ana e punonjesve te shoqerise, cka do te thote se ne ato moment, paditesi nuk i kishte ofruar ende mallin dhe klientet nuk e kishin perfutuar sherbimin dhe per kete arsye nuk mund te leshonte kuponin tatimor pa perfunduar sherbimi i kerkuar nga klientet.

Per kete arsye pretendimi i pales se paditur qe shoqeria nuk ka leshuar kuponin tatimor pasi ka ofruar mallin apo sherbimin eshte teresisht abuziv dhe i pambeshtetur ne prova e ne ligj.

Gjithashtu rezulton se pala e paditur eshte e vertete se ka pasqyruar veprimet dhe verifikimet e kryera ne momentin e ushtrimit te kontrollit prane paditesit por ne kundershtrim me ligjin nuk ka mbajtur proces-verbal per konstatimin e faktit, ne te cilin gjithashtu te pasqyroheshin me sakte rrethanat e ceshtjes por gjithashtu ti jepet mundesia edhe paditesit per te shprehur pretendimet e tij ne lidhje me pretendimet e ngritura ne punonjesit e D.R.T.Lezhe.

Ndodhur ne keto kushte paditesi i eshte drejtuar Drejtorise se Apelimt Tatimor, prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve dhe ka kundershtuar Njoftim Vleresimit per Detyrime nr.7035 prot. dt.07.10.2015 te Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe, per shkaqet dhe arsyet e siperciatuara.

Njoftimi i Detyrimit per Detyrime nr.7035 prot. dt.07.10.2015, per gjoben nga 50.000 leke per mosleshimin dhe rrezimin e ankimit, ka vendosur. Eshper ne fuqi te aktit administrative, Njoftim Vleresimit per Detyrime nr.7035 prot. dt.07.10.2015, per gjoben 50.000 leke per mosleshimin e kuponit tatimor.

Gjykata vlereson se:

Detyrimi per te instaluar dhe perdorur paisjen fiskale, percaktohet ne Ligjin nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne R.Sh-se", i ndryshuar, neni 54, 55 "Detyrimi per perdorimin e paisjeve fiskale", Udhezimin nr.24, date 02.09.2008, i ndryshuar ne zbatim te tij. Kreu VI, pika 55, dhe Vendirnin e KM nr.781, date 14.11.2007, i ndryshuar, Udhezimin nr.16 date 03.05.2010 "Per administrimin dhe dokumentimin e procedurave rre pajisjeve fiskale", i ndryshuar. Neni 54/3 i Ligjit nr.9920, date 19.5.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise".

"3. Te gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakice, qe shesin mallra apo ofrojne sherbime ne mjedise apo njesi te perhershme, te hapura per publikun, duhet te instalojne pajisje fiskale dhe te leshojne kupona tatimore per cdo transakcion."

Ndersa neni 55/1 i Ligjit nr.9920, date 19.5.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" parashikon se:

1. Tatimpaguesit, qe kryejne qarkullimin e mallrave dhe te sherbimeve, per te cilat pagesat nuk kryhen nepermjet bankes, jane te detyruar te fusin dhe te perdorin sistemin fiskal, nepermjet perdorimit te pajisjeve fiskale, per regjistrimin e pagesave me para ne dore dhe per leshimin, ne menyre te detyrueshme, te kuponit tatimor.

4. Ministri i Financave, me udhezitn, miraton proceduren dhe dokumentacionin per miratimin per perdorim te pajisjeve fiskale, elementet e kuponit tatimor, menyren e kontrollit dhe kontrollin e pajisjes fiskale, distancen e ruajtjes se kuponit tatimor dhe rregullat per mirembajtjen e tyre teknike e te sherbimit".

Ne Udhezimin nr.24 date: 02.09 .2008 "Per procedurat tatimore", ndryshuar,
"Detyrimi per perdorimin e Pajisjeve fiskale", pika 5.5 shprehet :

Personat e tatueshem, subjekte te tatimit mbi vleren e shtuar apo te tatimit mbi fitimin dhe personat e tatueshem, tatimpagues i tatimit te thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel" Jane te detyruar te pajisen, te perdorin dhe mirembajne pajisjet fiskale ne perputhje me dispozitat e Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 781, date 14. 11. 2007 "Per karakteristikat teknike e funksionale te pajisjeve fiskale, sistemit te integruar te kompjuterizuar per transferimet periodike, automatike te deklarimeve financiare, sistemit te komunikimit per proceduren e dokumentacionin per miratimin e tyre dhe per kriteret per pajisjen me autorizim t e shoqerive te autorizuar per ofrimin e pajisjeve fiskale" dhe akteve te tjera nenligjore ne zbatim te tij.

Ne nenin 46 te ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar eshte parashikuar detyrimi i tatimpaguesit per te leshuar fatura tatimore, deftesa tatimore ose kupon tatimor. ...

VKM nr. 781 date 14. 11.2007, percakton se : "te gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakice, qe shesin mallra apo ofrojne sherbime ne mjedise apo njesi te perhershme te hapura per publikun, instalojne pajisje fiskale dhe leshojne kupone tatimore per cdo transakcion".

Ne rastin konkret, pasi nuk kishte bere kontrollim fizik te kuponave te leshuar nga kasa ne mometin e konstatimit te pretenduar qe dy tavolina nuk l eshte gjetur kuponi tatimor.Ne rastin konkret rezulton se veprimtaria qe ushtron paditesi, eshte ajo e Bar -Resorant dhe nese rezulton se eshte e vertete qe klientet kishin hyre ne ambientet e shoqerise dhe kishin

porositur por ne ato moment ishin ende ne pritje te sherbimit nga ana e punonjesve te shoqerise, cka do te thote se ne ato moment, paditesi nuk i kishte ofruar ende mallin dhe klientet nuk e kishin perfutuar sherbimin dhe per kete arsye nuk mund te leshonte kuponin tatimor pa perfunduar sherbimi i kerkuar nga klientet. Per kete arsye pretendimi i pales se paditur qe shoqeria nuk ka leshuar kuponin tatimor pasi ka ofruar mallin apo sherbimin eshte teresisht abuziv dhe i pambeshtetur ne prova e ne ligj.

Gjithashtu eshte konstatuar se jane kryer dy veprime, akt njoftime nr.7035 prot. dt.07.10.2015 te Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe, gjobe 50.000 leke dhe "Njoftim Vleresimit per Detyrime" nr.9441/37 prot. dt.29.10.2015, 150.000 leke per te njeitin motiv, per mos leshim kuponi tatimore, duke e justifikuar si gabim njerezore i punonjeses se administrates tatimore, ne vleresimin e biznesit si biznes i vogel, duke mos perceptuar as detyrat e tyre funksionale, e duke renduar biznesin me papergjegjshmeri detyre.

Per pasoje referuar neni 37 te Ligjit nr.49/2012 date 03.05.2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative" pika 1 shpreh: Gjykata shqyrton ligjshmerine e veprimit administrativ qe kundershtohet, ne baze te provave te paraqitura nga palet dhe te situates ligjore dhe faktike qe ekzistonte ne kohen e kryerjes se veprimit konkret administrativ.

Gjykata konstaton se organi administrativ DRT -lezhe nuk arriti te provoje ligjshmerine e aktit mbi baze prove, pra te permbushe detyrimin ligjore sipas ligjit 9920/2008 dhe 49/2012 e se ne keto kushte gjykata vendose pranimin e kerkese padise sipas objektit dhe, meqenese vlera e aktit eshte me e vogel se 20 fishi i pages minimale ne shkalle vendi, ky vendim eshte i formes se prerë, prandaj

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar ne nenin 40, 41, 42 dhe 45 te ligjit nr 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative", nenit 126,306 dhe 310 te K.pr. Civile

VENDOSI

- Pranimin e kerkese padise.
- Shfuqizimin e aktit administrativ "Njoftim Vleresimit per Detyrime" nr.7035 prot. dt.07.10.2015, te Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe;
- Shfuqizimin e aktit administrativ "Njoftim Vleresimit per Detyrime" nr.9441/37 prot. dt.29.10.2015, te Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe;
- Shfuqizimin e vendimit nr.32956/1 Prot., dt.21.12.2015, te Drejtorise se Apelimt Tatimor, dhe shfuqizimin e vendimit nr.37836/3 Prot., dt. 14.01.2016 te Drejtorise se Apelimt Tatimor, prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tiranë.
- Ky vendim eshte i forme se prerë, perben titull ekzekutiv dhe do te ekzekutohet menjehere.
- Shpenzimet gjyqesore (ne vleren e taksës se padise 3000 lekë), ne ngarkim te anës se paditur.
- Kunder vendimit nuk lejohet ankim.
- Shkodër me date 26.09.2016

SEKRETARE SEANCE
Borana LITI



GJYQTARE
Valbona DURRAJ

